

DEKRET
Nr. 8354, datë 21.10.2013

PËR EMËRIM GJYQTARI

Në mbështetje të neneve 93 dhe 136, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 70, pika 5 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe të nenit 113 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”, me propozim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Ramiz Lala emërohet gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi në datën 4 nëntor 2013.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bujar Nishani